



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR
MIRATIMIN E SASISË SË FLETËVE TË VOTIMIT QË DO TË PRODHOHEN PËR ÇDO
QENDËR VOTIMI, PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 30.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Miratimi i sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", neni 56, neni 97, pika 4, dhe neni 99, pika 1, germa "a", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimi i KQZ-së nr. 1, datë 12.12.2012.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

VËREN

Në nenin 97, pika 4, të Kodit Zgjedhor theksohet që sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 përqind. Në nenin 99, pika 1, thuhet që KQZ dërgon në selitë e KZAZ-ve, të ndara në kuti të veçanta për çdo QV, veç të tjerash dhe numrin e nevojshëm të fletëve të votimit, në përputhje me numrin e zgjedhësve të regjistruar në QV, së bashku me numrin shtesë.

Për përcaktimin e numrit të zgjedhësve që do të votojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019 KQZ me udhëzimin nr.1, datë 12.12.2012 ka caktuar afatin dhe mënyrën e dërgimit nga kryetarët e njësisive të qeverisjes vendore në KQZ, të të dhënave me numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, së bashku me numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve për çdo QV.



Neni 10 i këtij udhëzimi, në pikën 1 dhe 2 të tij, përcakton: "Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore, menjëherë me miratimin e listës së zgjedhësve dhe jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, dërgon në KQZ dhe KZAZ-në përkatëse të dhëna për numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, së bashku me numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, në letër dhe në se është e mundur edhe në formë elektronike. Në rast se kompetencat e parashikuara në këtë nen nuk ushtrohen nga kryetari i njesisë së qeverisjes vendore, detyrimet sipas këtij neni, përmbushen menjëherë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile" .

Nga përpunimi i të dhënave, rezulton se në rang vendi janë gjithsej **5417** QV, me gjithsej **3.536.016** zgjedhës. Bazuar në urdhërimet e pikës 4, të nenit 97, të Kodit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, sasia e fletëve të votimit që duhet të prodhohet duke shtuar 2-përqindeshin mbi numrin e zgjedhësve, është gjithsej **3.606.815** fletë votimi.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", neni 97, pika 4, dhe neni 99, pika 1, germa "a", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Të miratojë sasinë e fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo qendër votimi për Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, sipas Lidhjes 1 bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

